



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.15/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj, dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e [REDAKTUAR], me vendbanim në Holandë, të parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos regjistrimit si votuese jashtë Kosove për Zgjedhje për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 09 shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 03.01.2025, merr këtë :

VENDIM

KONSIDEROHET e tërhequr ankesa Anr.15/2025 datë 01.01.2025, e parashtruar nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Holandë, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të mos regjistrimit si votuese jashtë Kosove për Zgjedhje për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09 shkurt 2025.

Arsyetim

Me datën 01.01.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë përmes emailit zyrtar nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Holandë, në të cilën thekson se KQZ-ja i ka refuzuar kërkesën për regjistrim si votues jashtë Kosove me arsyetimin se ka dokument të pa vlefshëm dhe me afat të skaduar. Andaj e njejta ka kërkuar që të regjistrohet si votuese jashtë vendit.

Bazuar në nenin 10.5 dhe 98 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Pergjithshme në Republikën e Kosovës, PZAP-i ka kërkuar nga pala ankuese që për parashtrimin e ankesës e njejta ti përmbahet kushteve siç parashihen me dispozitat ligjore për tu parashtruar një ankesë, dhe bazuar në nenin 11 paragrafi 9 i Rregullorës së PZAP-it 01/2024 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, duke ju është dhënë afat për plotësimin e kërkesës deri me datë 02.01.2025 në ora 17:00, dhe e ka njoftuar palën ankuese se ankesa do të konsiderohet e tërhequr, ndërsa nëse e njejta kthehet si e paplotësuar, do të hedhet poshtë.

Në nenin 10.4. të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Pergjithshme në Republikën e Kosovës në mënyrë decisive thuhet se “*Personi që ka aplikuar për t’u regjistruar si votues jashtë Kosovës, mund të parashtrrojë ankesë në PZAP, përmes postës ose sistemit elektronik, për mospërfshirjen e tij në Listën e votuesve, brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i njoftimit nga KQZ-ja*”.

Në nenin 10.5. të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Pergjithshme në Republikën e Kosovës në mënyrë decisive thuhet se: “*Ankesa e personit jashtë Kosovës që dorëzohet në PZAP në mënyrë elektronike, duhet të jetë e nënshkruar, e skanuar dhe duhet t’i këtë të bashkangjitura dokumentet valide të lëshuara nga organet kompetente të Republikës së Kosovës, të cilat*

identifikojnë ankuesin. Ankesa e tillë, dërgohet vetëm nga email - adresa personale e ankuesit”.

Ndërsa në nenin 11 paragrafi 9 të Rregullorës së PZAP-it 01/2024 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave në mënyrë decisive thuhet se: “Ankesa qe nuk i plotëson kriteret sipas nenit 5 te kësaj rregullore i kthehet paersonit ankues ne plotësim dhe permisim ne afat te caktuar nga Paneli deri në njëzet e katër (24) orë. Ankesa do të konsiderohet e tërhequr nëse nuk i kthehet përgjigje PZAP-it në afatin e dhënë, e në qofte se kthehet e pa plotësuar do të hedhet poshtë”.

Me qenëse pala ankuese nuk ju ka përmbajtur kërkesës së PZAP-it për plotësimin e ankesës, dhe nuk ka plotësuar ankesën e saj, Paneli bazuar ne nenin 10.5 dhe 98 të LZP-së, si dhe nenit 11 paragrafi 9 i Rregulloreë së PZAP-it 01/2024 ankesën e parashtruesit e konsideroi të tërhequr.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë bazë dhe nga arsyet e lartpërmendura, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 10.5, 98.3 dhe nenit 119.3 të LZP-së, si dhe nenit 11 paragrafi 9 i Rregulloreë së PZAP-it 01/2024 vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A.nr.15/2025 datë: 03.01.2025

Kryesues i Panelit
Bujar Muzaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.